



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:155789

Datë: 04.02.2021

Numri i dokumentit: 01475671

P.nr.1016/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL, sipas gjyqtarit Refki Piraj, me procesmbajtësen Kujtesa Uka, në lëndën penale kundër të ndaj të akuzuarit V.S., nga, me numër personal 1172762308, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope nga neni 269 par.2 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke vendosur sipas aktakuzës së PP/II.nr.1669-2/19 të datës 11.11.2020, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 04.02.2021, në praninë e Prokurorit të Shtetit Musli Gashi, të akuzuarit V.S., me datë 04.02.2021 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari V.S., i lindur më, me numër, i biri ii nënës, me vendbanim në, Rr. enr...., i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer fakulteti ekonomik, i pa martuar, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës.

I. Se me dt.28.08.2020, rreth orës 01,20, në pikën kufitare Vërmicë, pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope ose analoge në atë mënyrë që gjatë kontrollit si bashkë udhëtar në automjetin me targatek i akuzuari gjejnë një qese plastike me narkotik të llojit marihuanë, në peshë prej 1.61gr. ku pas raportit të ekspertimit të substancës narkotike me nr.AKF/2020-2074/2020-1804 të dt.27.10.2020, vërtetohet se substanca narkotike e lartë cekure është e llojit marihuanë me peshë neto të përgjithshme 1.04gr.

- Këso dore ka kryer veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope nga neni 269 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 38, 39, 40, 43, dhe 69 të KPRK, të akuzuarit i shqipton,

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 200€, të cilin është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë, nëse i dënuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën gjykata e zëvendëson dënimin me gjobë me dënim me burgim i cili do të llogaritet 20€ gjobë me një ditë burg gjegjësisht 10 ditë burg.

Konfiskohet substanca narkotike e llojit marihuan në peshë prej 1.04gr.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj te gjitha shpenzimet e procedurës penale sa ato bëhen ne baze te llogarisë se gjykatës, kurse ne emër te paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 20€, e te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nen kërcenim te ekzekutimit te dhunshëm.

Në zbatim të ligjit mbi mbrojtjen e viktimave të krimit të akuzuarit i caktohet taksa në shumë prej 30€, te cilën është i obliguar ta paguaj ne xhirollogarinë e kësaj gjykate ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë, dhe:

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.1669-2/19, të datës 11.11.2020, ndaj të akuzuarit V.S., nga Gjilani, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope nga neni 269 par.2 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

I akuzuari V.S., në shqyrtim fillestar e ka pranuar fajësinë.

Prokurori i shtetit nuk e kundërshton pranimin e fajësisë.

Gjyqtari gjykues konstatoi se janë përmbushur kërkesat nga neni 248 i KPP-së, nga se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi te fajit, pranimi është i vullnetshëm dhe i mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban aktakuza, andaj me aktvendim pranoi pranimin e fajësisë.

Kjo gjykatë gjeti se në veprimet e të akuzuarit, plotësohen të gjitha elementet qenësore te veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope nga neni 269 par.2 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, prandaj dhe ia shqiptoi dënimin me gjobë në shumë prej 200€, duke qenë e bindur se me këtë lloj dënimi do të arrihet qëllimi i tij, duke patur për bazë posaçërisht gjendjen ekonomiko sociale të të akuzuarit.

Me rastin e shqiptimit të dënimit kjo gjykate pati parasysh si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, pranimin e fajësisë, premtimin se në të ardhmen nuk do te kryejnë me vepra penale, sjelljen korrekte para gjykatës, posaçërisht me rastin e shqiptimit te gjobës pati për bazë gjendjen e tij të varfër ekonomiko sociale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është mare ne kuptim te nenit 450 dhe 452 të te KPPK-se.

Më sa u tha më lartë u vendos si ne shqiptim të këtij aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
2020:155789, 04.02.2021**

G j y q t a r i
Refki Piraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.